



## RAPORT

### MBI PRIORITETET E QYTETARËVE TË MBLEDHURA PËRMES VOTIMIT ONLINE

### NË BASHKINË PUKË

2019

## Publikim i të dhënave të kërkesave të qytetarëve në projektin: “Përmirësimi i Procesit të Buxhetimit të Konsultuar dhe me Pjesëmarrje” në Bashkinë Pukë

Të nderuar përfaqësues të pushtetit vendor,

**Lëvizja Rinore për Demokraci** në partneritet me **Institutin AGENDA** dhe mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, ka zbatuar një projekt që ka si qëllim kryesor rritjen e ndikimit direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive me anë të një instrumenti efikas. Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive është krijuar platforma **www.buxhetim.al** ku cdo qytetar mund të shprehë preferencat e tij për buxhetin e bashkisë. Në bashkinë Pukë platforma u shfrytëzua nga qytetarët gjatë periudhës 30 tetor - 15 dhjetor 2019. Të dhënat e mbledhura nga aplikacioni janë përpunuar dhe analizuar nga stafi dhe ekspertët e Institutit, duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. Duke i shpërndarë këto të dhëna pranë drejtuesve të Bashkisë dhe Këshillit bashkiak, synohet informimi i autoriteteve mbi mendimet e shprehura nga qytetarët dhe mundësia që të merren parasysh në hartimin e buxhetit përfundimtar.

### Të dhënat e mbledhura në Bashkinë Pukë

Nga bashkia Pukë 570 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, nga të cilët 324 janë *meshkuj* dhe 246 janë *femra*.




Figura 1.1 Gjinia e qytetarëve




Figura 1.2 Mosha e qytetarëve



Figura 1.3 Arsimimi i qytetarëve

- **Kategoritë e buxhetit**




Figura 1.4 Kategoritë e buxhetit

- **Nënkategoritë e buxhetit**

Zërat e buxhetit	Numri	Përqindja
Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive	234	14%
Administrimi i pyjeve	191	11%
Organizimi i aktiviteteve kulturore	148	9%
Mirëmbajtja e rrugëve rurale	141	8%
Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe	110	7%
Ujitja dhe kullimi	102	6%
Ndriçimi publik	100	6%
Arsimi 9 vjeçar	86	5%
Qendra për ofrimin e shërbimeve sociale	86	5%
Mbrojtje sociale	70	4%

Tabela 1.1 Nënkategoritë e buxhetit

- **Prioritetet sipas gjinisë**




Figura 1.5

- **Prioritetet sipas moshës**




Figura 1.6

- **Prioritetet sipas arsimimit**




Figura 1.7

## • Sugjerimet e qytetarëve të Pukës

1. Duhet rishikuar masa e ndihmes ekonomike 3000 lek/muaj për një familje me 3-4 persona nuk mjaftojnë as për bukë e kripë. Vëmendje të veçantë ndaj familjeve me kryefamiljar gra për shkak të divorceve apo fatkeqësive në familje. Banesat sociale duhet ju jepen familjeve në nevojë e jo të përcaktohet kushti, po ke të paktën një rrogë mbi 30000 lek/muaj, ashtu nuk përfiton asnjë familje në nevojë. Të rinjtë e Pukës kanë nevojë për aktivitete të ndryshme dhe bashkitë Puke e Fushë Arrëz duhet të ndajnë fonde.
2. Buxhete vendore për të rinjtë për aktivitete të ndryshme.
3. Shkolla Migjeni duhet ristrukturuar duke filluar me dritaret oxhaqet.
4. Turizmi dhe punësimi i të rinjve.
5. Punësimi i të rinjve. Zhvillimi i turizmit. Taksa të reduktuara për periudhën Tetor - Mars për Pukën.
6. Banesat sociale për të pastrehët të ndahen me drejtësi.

7. Mendoj se do ishte futur në buxhet edhe bursat për nxënësit më të mirë.
8. Investime në fabrika ose hapje të qendrave sidomos për punësimin e grave.
9. Zgjedha këto pasi mendoj duhet të investohet më shumë, por nuk përjashtoj asnjë nga pikat e tjera. Duke qenë se kisha mundësi zgjedhje vetëm tre, mendoj se këto janë prioritet pa lënë pas dore dhe pikat e tjera. Faleminderit!
10. Të kemi mbështetjen e bashkisë në lidhje me udhëzimin e fillim vitit shkollor për klasën parapërgaditore.
11. Fonde për mbjelljen e pyjeve dhe parandalim nga sëmundja (Proqesonarja) që po shkakton një dëm të madh në pyjet me pisha të cilët janë mushkri për qytetin tonë.
12. Rinia të ketë një punë ose angazhim, për secilin të ri ka rëndësi që koha e tij të jetë sa më zënë për mirëqenien e vetes së vet dhe komunitetin gjithashtu.
13. Mendoj se fokusimi në këto tre alternativa që une zgjedha do të jenë shumë prioritet për Pukën.
14. Zhvillimi i turizmit. Politika punësimi, ikën krejt rinia. Arsim cilësor.



**Përmirësimi i Procesit të  
Buxhetimit të Konsultuar  
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and  
Participatory Budgeting Process**